



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDARYSHE**

*23 korrik 2018, Prizren*

**KOMUNIKATË  
Drunj të pastër**

Sot është realizuar performanca publike “Drunj të pastër” e cila shërben si një thirrje e radhës për ruajtjen ambientit në qytetin e Prizrenit. Kjo performancë është mbajtur si rezultat i shqetësimeve të vazhdueshme të qytetarëve për dëmtimin e drunjve si pasojë e vendosjes së reklamave dhe shpalljeve në ta. Duke qenë se Qendra Historike e Prizrenit në hulumtimet e mëparshme të realizuara nga EC është evidentuar si një zonë me mungesë të hapësirave gjelbëruese atëherë edhe kujdesi ndaj këtyre drunjve të paktë duhet të jetë maksimal, pasi që ata janë atribuesit kryesor në pastërtinë e ajrit, hijen që krijojnë dhe janë pjesë e rëndësishme e peisazhit të qytetit të Prizrenit.

Me anë të aktivitetit/performancës “Drunj të pastër” EC, ORKIDE dhe X40 fillimisht i kanë pastruar drunjte nga reklammat dhe shpalljet që gjinden në to për të vazhduar tutje me mbështjelljen e të gjithë drunjve/lisave që gjenden në rrugën “Shuaip Spahiu”, “Remzi Ademaj” dhe në Sheshin “Shatërvan” me punime dore të cilat kanë motive tradicionale. Ky aktivitet përveç që shërben si një mesazh për ruajtjen e drunjve, ai njëkohësisht bën promovimin e punimeve të grave të qytetit të Prizrenit. Aktiviteti do të vazhdojë të realizohet gjatë një jave ku gratë do të vendosin punëdoret e tyre në trupat e këtyre lisave.

EC Ma Ndryshe edhe më parë ka reaguar mbi fenomenin e dëmtimit të drunjve në Qendrën Historike të Prizrenit nga shpuarja e tyre si pasojë e reklamave dhe kishte prezantuar tabela model që do të shërbenin për vendosjen e materialeve të tilla promovuese apo njoftuese.

Ky aktivitet është thirrja e radhës që bëhet për institucionet që të merren hapa konkret në ofrimin e alternativave për vendosje të materialeve të tilla në qytet dhe njëkohësisht është edhe një thirrje që drunjte të mos shfrytëzohen në forma të tilla.

Performanca publike “Drunj të pastër” u organizua ne kuadër të projekti "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" i cili përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë.

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771